



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 507/29 Prot.

Tiranë, më 02.12.2016

V E N D I M

Nr. 143, Datë 02.12.2016

PËR
EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TEMATIK TË
USHTRUAR NË SUBJEKTIN “KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK”
MBI “ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË SË
VEPRIMTARISË EKONOMIKO-FINANCIARE” NË LIDHJE ME
PROCEDURËN E PROKURIMIT “NDËRTIMI I BANESËS TIP 83/5, 8
KATE ME 38 APARTAMENTE DHE TRE NJËSI SHËRBIMI” NË
LUSHNJË

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve e Projekteve me Financime të Huaja dhe Shoqërive Publike dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e ligjshmërisë, dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në subjektin “Komisioni i Prokurimit Publik” Tiranë, për zhvillimin e procedurave të prokurimit “Ndërtimi i banesës tip 83/5, 8 kate me 38 apartamente dhe 3 njësi shërbimi” në lushnjë” në qytetin Lushnjë .

II. Të përcjellë në Komisionin e Prokurimit Publike Raportin Përfundimtar të Auditimit, të kryer në zbatim të programit të auditimit nr. 507/1 date 25.05.2016, i ndryshuar me vendimin nr.97 datë 23.07.2016 të Kryetarit të KLSH-së.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R